

Raport përfundimtar viti 2011

TITULLI I PROJEKTIT:

“ Forma optimale e krasitjes së vreshtave në kultivarët e hershëm për tryezë”.

1. Hyrje, Justifikimi i kërkimit, vendi, stafi pjesëmarrës i kërkuesve dhe ekstensionistëve etj,

Në kompleksin e masave agroteknike, krasitja dimërore përfaqëson aspektin më të rëndësishëm teknik në hardhi, pasi ka të bëjë direkt me vendosjen e ekuilibrit të drejtë biologjik midis masës vegetative dhe sistemit rrënjor të bimës, midis prodhimit dhe vegetacionit, raporte që ndikojnë direkt në rendimentin dhe cilësinë e prodhimit. Sot në botë njihen mjaft sisteme dhe forma krasitje, në përputhje me kultivarët në ekosisteme të ndryshme kultivimi. Por gjithsesi nuk mund të jepen receta standarte krasitje, për vetë shumëllojshmërinë e kultivarëve, formave të ndryshme të mbarështrimit, kushteve të ndryshme pedoklimatike, destinacionit të prodhimit etj. Kohët e fundit në vëndin tonë kanë hyrë në kultivim mjaft varietete të huaja, studimi i të cilëve në aspektin e procesit të krasitjes dimërore, në kushtet e vëndit tonë, do të ishte me mjaft interes, pasi më parë tek këta kultivarë nuk ka pasur studime të këtij karakteri. Studimi ndërmeret në kuadrin e kërkjes së fermerëve për përcaktimin e një ngarkese optimale në sytha në bimë, në kultivarët e hershëm për tryezë, për marjen e prodhimeve cilësore dhe me rendimente të larta tek këta kultivarë. Në studim u muar kultivari “Victoria”, si kultivari i tryezës më i përhapur kohët e fundit në vëndin tonë.

Studimi i u ngrit në fshatin Cerkovinë, Komuna Novoselë, Vlorë.

Projekti u udhëhoq nga z. H.Fiku, në bashkëpunim me D.R.B.U.M.K. Vlorë, përfaqësuar nga z. Sh.Roshi, ekstensionisti i ngarkuar z. Dh.Shahini si dhe fermeri, pronar i vreshtit z.V. Musaj.

2. Objektivi i kërkimit

Objektivi kryesor i studimit është përcaktimi i ngarkesës më optimale në sytha në kultivarin “Victoria”, në aspektin e rendimentit të prodhimit, cilësisë së tij dhe rjedhimisht në efektivitetin ekonomik.

3. Metodatat dhe materialet e përdorura: skema e eksperimentit, trajtimet, inputet, metodologjia etj.

Studimi u ngrit në vreshtin me sipërfaqe .5 dyn., në fshatin Cerrkovinë, në komunën Novoselë (Vlorë). në kultivarin ”Victoria”.(destinacion tryeze), me moshë 6 vjeçare, me fermer z. ..Vesaf Musaj. Tre varjantet e marë në provë ishin:

V1: Dëshmues me ngarkesë 12 sytha, forma kordon, sipas skemës 6 çepa x 2 sytha.

V2. Krasitje me ngarkesë 20 sytha sipas skemës 6 çepa x 2 sytha + 1 sharmend prodhues me 8 sytha

V3: Krasitje me ngarkesë 10 sytha sipas skemës 5 çepa x 2 sytha

Të tre variantet u ngritën në tre përsëritje, ku për çdo variant u trajtuan 15 bimë (konform metodikës së hartuar), duke marrë për studim 5 bimë në çdo përsëritje të varjantit. Si skemë ngritje e eksperimentit u zbatua ajo “Runker në vijim”, vendosur skematikisht si më poshtë:

V1P1 V2P1 V3P1 V1P2 V2P2 V3P2 V1P3 V2P3 V3P3

Variantet u vlerësuan me metoda vizive për fenomenin e milerandimit e të uniformitetit në pjekje dhe me anë të matjeve për treguesit sasiorë (prodhimi me dinamometër dore, përmbajtja e sheqerit me refraktometër dore dhe zyre, dhe aciditeti me metodën e titrimit me Naoh 0.1 N).

Për të gjithë variantet në provë u aplikua e njëjta agroteknikë e cila u regjistrua në fletore sipas proceseve të kryera dhe kohës së zbatimit të tyre.

4. Rezultatet: përshkrimi i rezultateve (te dhëna dhe vrojtime) dhe rezultatet e analizës statistikore.

Mbështetur në metodikën e hartuar, rezultatet e studimit jepen nëpërmjet treguesve të marrë, paraqitur në tabelën e mëposhteme.

Tab.1. Përmbledhëse e treguesve kryesore.

Varianti e përsëritja	Nr. mesatar i bistakëve në vjelje	Prodhimi Gram/bimë	Pesh mesat. bistakut	Përmbajtja e sheqerit në %	Përmbajtja e acidit në ‰
V1P1	13	3620	279	12.8	7.5
V1P2	11.2	3840	343	12.6	7.9
V1P3	15.8	4740	282	12.0	8.2
Mes, V1	13.3	4066	301	12.4	7.8
V2P1	19.4	5360	276	11.6	8.6
V2P2	19.2	5340	278	11.8	7.9
V2P3	22.2	5740	258	11.7	8.2
Mes,V2	20.2	5480	270	11.7	8.2
V3P1	10.4	3500	336	12.7	7.1
V3P2	11.4	3420	300	12.7	7.6
V3P3	13.6	4100	301	12.4	7.8
Mes.V3	11.8	3673	312	12.6	7.5

Tab 2. Përmbledhëse e mesatares së varianteve

Variantet	Nr. mesatar i bistakëve në vjelje	Prodhimi Gram/bimë	Pesh mesat. bistakut	Përmbajtja e sheqerit në %	Përmbajtja e acidit në ‰
Mes, V1	13.3	4066	301	12.4	7.8
Mes,V2	20.2	5480	270	11.7	8.2
Mes.V3	11.8	3673	312	12.6	7.5

Tab.3. Vrojtime për milerandimin dhe uniformitetin e pjekjes.

Varjanti	Çfaqje e milerandimit të kokrrave	Uniformiteti në pjekje.
V1	Milerandime të pakta deri mesatare të kokrrave	Pjekje uniforme e bistakut pa diferenca të theksuara
V2	Milerandim kryesisht i theksuar në bistakët e dalë nga sharmenda e prodhimit	Uniformitet jo i kënaqshëm sidomos në bistakët e sharmendës
V3	Milerandim i pakët	Pjekje uniforme e bistakut

Rezultatet e analizës statistikore.

Analizës statistikore ju nënështruan 2 treguesit kryesorë, rendimenti i prodhimit dhe përmbajtja e sheqerit.


Tabela 4. Treguesi 1. Prodhimi

Varianti	Prodhimi gram/bimë	Grupet homogjene
V1	4066	a
V2	5480	b
V3	3673	a
D. M. V. = 660.3		


Tabela 5. Treguesi 2. Përmbajtja e sheqerit

Varianti	Përmbajtja e sheqerit në %	Grupet homogjene
V1	12.4	a
V2	11.7	b
V3	12.6	c
D. M. V. = 0.118		

Paraqitja grafike e prodhimit



Paraqitja grafike e sheqerit



5.Vlerësimi i rezultateve: opinionet e fermerëve dhe ekstensionistëve.

Gjatë gjithë kohës së realizimit të studimit, me pronarin ku u krye studimi z.V.Musaj i cili ishte mjaft i interesuar dhe i impenjuar për problemin në studim, punëtorët e vreshtit (edhe ata posedues të sipërfaqeve me vreshta), apo edhe me fermerët e zonës për rreth , është diskutuar në vënd efekti i ngarkesës në hardhi, aq më tepër për një kultivar tryeze, pamja tregtare e të cilit është determinant në tregtimin e prodhimit, duke qënë të gjithë të interesuar sidomos në rritjen e cilësisë së rrushit. Vlen të theksohet se cv. Victoria ka një koeficient të lartë pjellorie (edhe nga sythat bazalë). Pronari V.Musaj, i bindur për

rezultatit, duke parë ndikimin, kërkon vitin e ardhshëm, zbatimin e konkluzioneve të studimit në të gjithë vreshtin.

6.Vlerësimi ekonomik: llogaritja e shpenzimeve dhe te ardhurave.

Vlerësimi ekonomik është bërë bazuar në të ardhurat për ha, për çdo variant. Të ardhurat rezultojnë nga rendimenti teorik (prodhimi mesatar për bimë x numurin e bimëve/ha, që në rastin konkret është 3500 bimë/ha), shumëzuar me çmimin e shitjes. Tabela e mëposhtëme pasqyron qartë diferencën e të ardhurave midis varjanteve :

Tabela 6. Efektiviteti ekonomik.

Varjanti	Rendimenti kv./ha	Çmimi i shitjes (lek/kv.)	Të ardhura (lek)	Të ardhurat në %
V1	142	13000	1846000	111
V2	191	10000	1910000	115
V3	128	13000	1664000	100

7.Diskutime dhe konkluzione: diskutimi i rezultateve, aplikimi i përgjithshëm i tyre, konkluzione teknike dhe ekonomike.

Në tabelën nr.1, jepen qartë rezultatet e arritura në treguesin e **prodhimit**, ku ndryshimet midis varianteve rezultojnë: Ndërmjet variantit të parë dhe të dytë, ndryshimi është me një diferencë prodhimi prej 26 % në favor të V2, ndërsa në V3 kemi një prodhim 10% dhe 33% respektivisht më pak se V1 dhe V2. Ky tregues edhe sipas analizës statistikore, rezulton me ndryshim të vërtetuar statistikor ndërmjet V2 nga njëra anë dhe V1 e V3 nga ana tjetër, ndërsa midis V1 dhe V3 nuk ka ndryshim të vërtetuar statistikor.

Në treguesin e **përmbajtjes së sheqerit** varjanti me përmbajtje më të lartë sheqeri rezulton v3 i cili ka 0.2 dhe 0.9% më shumë respektivisht se V1 dhe V2. Treguesi i përmbajtjes së sheqerit rezulton i vërtetuar statistikisht për të tre varjantet. Megjithatë duhet theksuar se përmbajtja e sheqerit ka rëndësi sekondare në kultivarët e tryezës.

Në treguesin e **peshës mesatare të bistakut**, me vlerë më të lartë rezulton V3 (312 gr.),dhe kjo spjegohet me ngarkesën më të vogël të aplikuar në këtë variant,(10 sytha).Ndryshimi midis V3 dhe V1 është vetëm 11 gram në favor të V3. Varjanti V2 rezulton me peshë bistaku më të vogël (270 gram), me një diferencë prej 31 dhe 42 gram më pak se V1, dhe V3, ç’ka vërteton raportin e zhdrejtë ndërmjet ngarkesës në sytha dhe peshës së bistakut.

Në treguesin e fenomenit të milerandimit që është i rëndësishëm në kultivarët e tryezës, milerandimi i kokrave në bistakët e dalë nga lastarët e çepave, rezulton një fenomen i pranishëm por pa ndonjë diferencë të theksuar midis varjanteve. E rëndësishme është të theksohet se ky fenomen është mjaft i dallueshëm madje edhe problematik në bistakët e dalë nga sharmenda e prodhimit në varjantin e dytë, duke i prishur së tepërmi bistakut pamjen tregtare duke e bërë të pavlefshëm për tregtim.

Edhe në treguesin e uniformitetit të pjekjes së kokrave, përgjithësisht nuk ka dallime esenciale, midis varjanteve, me përjashtim të bistakëve të dalë nga lastarët e sharmendës së prodhimit,(V2), ku nuk rezulton një pjekje uniforme e bistakut, si rezultat i një dëndësie më të madhe të masës vegjetative.

Referuar tabelës së të ardhurave (tab.6), e cila bazohet kryesisht në rendimentet e mara sipas varjanteve, teorikisht varjanti më efektiv rezulton V2 (11% dhe 15 % më i lartë respektivisht ndaj V1 dhe V3. Por e parë në syrin e një analize më të thellë ekonomike, rezulton se te ky varjant, janë disa faktorë që kufizojnë aplikimin e tij.

E para: Vështirësohet së tepërmi tregtimi i prodhimit si rezultat i cilësive inferiore të bistakëve të sharmendit të prodhimit.

E dyta: Si rezultat i masës së madhe vegjetative që krijohet në hapësirën e vetë lastarëve të sharmendës, vështirësohet mbrojtja e prodhimit nga sëmundje e dëmtues si dhe vetë administrimi i bimës në përgjithësi. Krijimi i hijes në bistakë, sjell direkt ulje cilësore të rrushit.

Së treti: Tregues të tillë si ai i peshës mesatare të bistakut, përmbajtjes së sheqerit, milerandimit apo uniformitetit në pjekje, në varjantin e dytë këta tregues rezultojnë më inferiorë se në varjantin e parë dhe varjantin e tretë.

Së katërti: Në diskutim edhe me vetë fermerin e vreshtit dhe të tjerë fermerëve të zonës, në përcaktimin e aplikimit të formës më të efektshme të krasitjes, që përmbush interesat e tyre, në cv. "Victoria" varjanti më i efektshëm do të ishte ai i pari.

8. Mesazhet e ekstensionit (Rekomandime).

Mbështetur në analizën e rezultateve dhe konkluzionet e dala rekomandojmë se në cv. "Victoria" në formën e mbajtjes së vreshtit kordon i dyanshëm, të aplikohet krasitja e sistemit të shkurtër, forma "kordon Roaja" me ngarkesë prej 12 sytha për bimë, të shpërndarë në 6 çepa në të dy anët e kordonit. Mbështetur në rezultatet e arritura, analizën ekonomike si dhe vetë cilësinë e cv.

"Victoria" si një cv. me pjellori të lartë edhe nga sythat bazalë, aplikimi i krasitjes me lënie të ndonjë sharmendi prodhimi do të ishte e panevojëshme, përkundër do të sillte ulje ciësore të rrushit.

Përhapja (propagandimi) i rezultateve.

Aplikimi i formave të krasitjes së sistemit të shkurtër me ngarkesë reduktuar, kryesisht në kultivarët e rrushit për tryezë, me koeficient të lartë prodhueshmërie, duhet parë në aspektin e kërkesave gjithnjë në rritje të konsumatorit për rrush të freskët, ndërkohë që do të ishte edhe një përgjigje e përballimit të konkurrencës në treg. Këto do të ishin argumenta bindëse për të ndërgjegjësuar fermerin tonë në zbatimin e kësaj hallke agroteknike, ndoshta më e rëndësishmja në zinxhirin e gjatë të shërbimeve agroteknike në vreshtë.

Si formë rezultative e përhapjes së kësaj eksperience, do të ishte planifikimi i dy demonstrimeve fushore me fermerë kultivues të vreshtave me destinacion tryeze; i pari në kohën e krasitjes, dhe i dyti në kohën para vjeljes së prodhimit për të krijuar bindjen e efektit të kësaj forme krasitjeje. Demonstrimi mund të organizohet edhe në shkallë qarku me fermerë të zonës ose dhe më gjerë.

Krahas demonstrimit praktik, me interes do të jetë shpërndarja e fletëpalosjes, fermerëve që kultivojnë vreshta të rrushit për tryezë, përgatitur nga stafi i projektit.

Në realizimin me sukses të projektit, meritë kanë gjithë stafi i projektit, e veçanërisht, specialisti i D.R.B.U.M.K. z. Dhimitër Shahini, i ngarkuar nga ana e kësaj Drejtorie për ndjekjen studimit, me impenjimin dhe angazhimin e admirueshëm të tij, fermeri pronar i vreshtit z. Vesaf Musaj, me gatishmërinë dhe lehtësirat e krijuara për ngritjen e studimit, si dhe specialistja e laboratorit z. Nikoleta Bimo.

21. BUXHETI - (I detajuar sipas zërave të 602)
Shprehur në 000/lek

Nr. i artikullit	Emertimi i artikullit	Plan vjetor 000/lek	3/I	3/ II	3/III	3/ IV
602 01	Kanceleri	2	1		1	-
	Gaz për ngrohje	3	2			1
602 4	Shërbime udhëtimi	-				
Totali		5	3		1	1

Drejtuesi i projektit
Hipokrat Fiku

Përgj.financës
Vangjel Buzo

Drejtori
Prof.as.Dhimitër Panajoti

Për D.R.B.U.M.K. Vlorë
Përgj. Shërb.Këshillmor
Shemsi Roshi

Ekstensionist
Dhimitër Shahini